

VENDIM
Nr.196, datë 13.4.2007

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “PRODHIMI DHE SHPËRNDARJA E DOKUMENTIT TË IDENTITETIT DHE TË PASAPORTAVE ELEKTRONIKE TË SHTETASVE SHQIPTARË”
DHE PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007,
MIRATUAR PËR MINISTRINË E BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.8952, datë 10.10.2002 “Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë”, të pikave 4, shkronja “a”, e 5 të nenit 19 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Prodhimi dhe shpërndarja e dokumentit të identitetit dhe të pasaportave elektronike të shtetasve shqiptarë”, sipas aneksit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’i shtohet fondi prej 2 027 000 000 (dy miliardë e njëzet e shtatë milionë) lekësh, për prodhimin e dokumentit të identitetit të shtetasve shqiptarë.
 3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha